



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 36 /2021
Datë: 25/03/2021

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr.06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, (08.06.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr.07/2020, (16.06.2020), Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet vendimi nr. 73/2020, dt. 27.07.2020, me të cilin z. Dritan Bajramaj është caktuar Zëvendësues Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për administratë, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Obligohet Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin nr. 73/2020 të datës 27.07.2020, z. Dritan Bajramaj është caktuar Zëvendësues i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Korrektues të Kosovës për administratë.

Ligji nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, respektivisht neni 215 dhe 216 (paragrafi 2) i tij përcaktojnë në mënyrë të qartë kushtet, kriteret dhe procedurën për zgjedhjen e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, si nëpunës i kategorisë së lartë drejtuese.

Ndërsa, Ligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nuk e specifikojnë mënyrën e zgjedhjes së zëvendësuesit të zv. drejtorit të përgjithshëm të një agjencie ekzekutive.

Meqenëse ky vendim nuk ka bazë ligjore dhe nuk është në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- Z. Dritan Bajramaj;
- Kabinetit të Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të MD-së.